



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2026

PËR

**DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 162, DATË 19.02.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME PËR HARTIMIN,
MIRATIMIN, RISHIKIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË
PAKËSIMIT TË SHKARKIMEVE NË AJËR"¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 17, të ligjit nr. 162, datë 4.12.2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në Aneksin III, bashkëlidhur vendimit nr. 162, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pjesën 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas paragrafit hyrës shtohet paragrafi me përmbajtjen si vijon:

"Projeksionet e shkarkimeve të përdorura në program përgatiten dhe përditësohen të paktën çdo dy vjet, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian për pakësimin e shkarkimeve të ndotësve të ajrit."

b) Pas nënndarjes (iii) të shkronjës "a" të pikës 1 shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

"Projeksionet e shkarkimeve përgatiten dhe analizohen në nivelin e kategorive individuale të burimeve sipas Nomenklaturës për Raportim (NFR), me qëllim

¹ Ky vendim përafrohet në mënyrë të pjesshme Direktivën (BE) 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2016, "Për Reduktimin e Shkarkimeve Kombëtare të disa Ndotësve Atmosferik (Direktiva NEC)", Numri CELEX 32016L2284, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 344, datë 17.12.2016, fq. 1-31.

sigurimin e përputhshmërisë me raportimin e inventarëve kombëtarë të shkarkimeve në ajër.”

c) Pas shkronjës “b” të pikës 1 shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Projeksionet e shkarkimeve përgatiten duke përdorur metodologjinë dhe formatin e raportimit në përputhje me udhëzimet e raportimit të Konventës së Komisionit Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët (LRTAP), si dhe me kërkesat përkatëse të legjislacionit të Bashkimit Evropian për pakësimin e shkarkimeve të ndotësve në ajër.”

2. Në pjesën 2 bëhen këto shtesa:

a) Në paragrafin hyrës, në fund, shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Masat e përshkruara në këtë pjesë zbatohen duke marrë në konsideratë dokumentin më të fundit udhëzues të UNECE-së për reduktimin e shkarkimeve të amoniakut, si dhe teknikat më të mira të disponueshme.”

b) Në fund të seksionit B, shtohet paragrafi me përmbajtjen si vijon:

“Shkarkimet e karbonit të zi monitorohen dhe raportohen si pjesë e inventarit dhe projeksioneve të shkarkimeve të lëndës së ngurtë pezull (PM2.5), duke marrë në konsideratë edhe burimet përkatëse të djegies së biomasës dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve bimore, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi.”

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA